



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec



Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/05 Nr. i faq/Br.str/No.pg 74
Data/Datum/Date 31/01/2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më datë 31.01.2025 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim, formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 04/25 i datës 31.01.2025 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës P-71510057-05864-0 dhe P-71510057-05865-0 në zonën kadastrale Rahovec.
2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. **Besmire Bytyqi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.2. **Erhan Morina**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.3. **Afrim Berisha**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës - AAK;
 - 2.4. **Feriz Thaqi**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës- AAK;
 - 2.5. **Nazmi Bellaqa**, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 5 (pesë) vjet të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdoherë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

Nr.05/25
Datë:31.01.2025

